



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA LIBRAZHD

SPECIFIKIMET TEKNIKE

OBJEKTI: “HIDROIZOLIMI I SHKOLLAVE DHE INSTITUCIONEVE”

Mars, 2023

1. Specifikime te pergjithshme

1.1 Njësitë matëse

Në përgjithësi njësitë matëse të përdorura janë njësi metrike në mm, cm, m, m², m³, Km, N(Njuton), Kg dhe gradë celcius.

1.2 Grafiku i punimeve

Kontraktuesi duhet t'i japë Mbikqyrësit të punimeve një program të plotë duke i treguar rendin, procedurën dhe metodën sipas së cilave, ai propozon të punohet në objekt deri në mbarim të punës.

Informacioni që mban Mbikqyrësi i punimeve duhet të përfshijë:

- vizatime që tregojnë rregullimin e përgjithshëm të terrenit të përkohshme, të cilat ai i propozon për përdorim,
- detaje të vendosjes së strukturave të përkohshme (skeleri, etj.),
- plane të tjera që ai propozon për përfundimin e të gjitha punëve,
- detaje të fuqisë punëtore të kualifikuar,
- supervizionin e punimeve.

Mënyra dhe rregulli që janë propozuar për të ekzekutuar punimet permanente është temë për t'u rregulluar dhe miratuar nga Mbikqyrësi i punimeve, dhe çmimi i kontratës duhet të jetë i tillë që të përfshijë çdo rregullim të nevojshëm, të kërkuar nga Mbikqyrësi i punimeve gjatë zbatimit të punimeve.

1.3 Punime të gabuara

Çdo punë, që nuk është në përputhje me këto specifikime, duhet refuzuar dhe kontraktuesi duhet të riparojë çdo defekt me shpenzimet e veta, sipas projektit.

1.4 Vizatimet e punimeve të zbatuara dhe libreza e masave

Kontraktori do t'i përgatisë dhe dorëzojë Mbikqyrësi i punimevet tre grupe të dokumentacioneve të punimeve sipas projektit. Ky material duhet të përmbajë një komplet të vizatimeve të projektit të zbatuar, vizatimet shtesë të bëra gjatë zbatimit të punimeve të aprovuara nga Mbikqyrësi I punimeve, si dhe librezat e masave për çdo volum pune.

1.5 Dorëzimet tek Mbikqyrësi i punimeve

Kontraktori duhet t'i dorëzojë Mbikqyrësi i punimevet për çdo punim shtesë, një vizatim të detajuar dhe puna duhet të fillojë vetëm pas aprovimit nga Mbikqyrësi i punimeve. Kontraktori duhet të nënshkruajë propozime, detaje, skica, llogaritje, informacione, certifikata testi, kurdo që të kërkohej nga Mbikqyrësi i punimeve.

1.6 Dokumentat dhe vizatimet

Kontraktori do të verifikojë të gjitha dimensionet, sasinë dhe detajet të treguara. Grafikët, ose të dhëna të tjera dhe Punëdhënësi nuk do të mbajë përgjegjësi për ndonjë mangësi ose mospërputhje të gjetur në to.

Kontraktori do të marrë përsipër të gjithë përgjegjësinë në bërjen e llogaritjeve të madhësive, llojeve dhe sasive të materialeve dhe pajisjeve të përfshira në punën që duhet bërë sipas Kontratës. Ai nuk do të lejohet të ketë avantazhe nga ndonjë gabim ose mospërputhje, ndërsa një udhëzim i plotë do të jepet nga Punëdhënësi nëse zbulohen gabime të tilla ose mospërputhje.

1.7 Mbrojtja e ambientit

Kontraktori duhet të ndërmarrë të gjithë veprimet e mundëshme për të siguruar që sheshi të ruhet dhe që vijat e ujit, toka dhe ajri (duke përfshirë edhe zhurmat) të jenë të pastra nga ndotja për shkak të punimeve të kryera.

1.8 Punime hidroizolimi dhe tarrace

Ky zë përfshin vendosjen e shtresës hidroizoluese në tarracë, sipas vizatimeve në fletët grafike. Hidroizolimi duhet shtrirë në një sipërfaqë të thatë, të niveluar më parë, duke përfshirë sipërfaqe. Mbi këtë vendosen dy fletë bituminoze, me fibër minerale, secila me trashësi min 3 mm. Sygjerohet që shtresa hidroizoluese të sigurojë hidroizolim absolut kundër ujit, borës dhe lagështisë. Gjithashtu duhet të ketë një depërtueshmëri të kënaqshme të avullit që lejon kalimin e avullit por jo të ujit. Duhet të ketë peshë të bituminoze, me fibër minerale, secila me trashësi min 3 mm. Sygjerohet që shtresa hidroizoluese të sigurojë hidroizolim absolut kundër ujit, borës dhe lagështisë. Gjithashtu duhet të ketë një depërtueshmëri të kënaqshme të avullit që lejon kalimin e avullit por jo të ujit.

2. Punime hidroizolimi dhe tarrace

2.1 Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 shtrese k katrama

Ky zë përfshin vendosjen e shtresës hidroizoluese në tarracë, sipas vizatimeve në fletët grafike.

Hidroizolimi duhet shtrirë në një sipërfaqë të thatë, të niveluar më parë, duke përfshirë sipërfaqe vertikale, të trajtuara me shtresë të parë bituminoze si veshje e pare. Sygjerohet që shtresa hidroizoluese të sigurojë hidroizolim absolut kundër ujit, borës dhe lagështisë. Gjithashtu duhet të ketë një depërtueshmëri të kënaqshme të avullit që lejon kalimin e avullit por jo të ujit. Duhet të ketë peshë të lehtë ($\leq 200 \text{ gr/m}^2$) dhe rezistencë të lartë mekanike. Rezistencë ndaj ndryshimeve të temperaturës (-40 - 100C). Rezistencë të lartë ndaj zjarrit. Çdo gje tjetër të nevojshme për perfundimin dhe realizim të taraces në menyre perfekte.

Ky çmim jepet për njësi Lekë/m².

2.2 Ulluk shkarkimi vertikal me pvc Ø 120

Ky çmim përfshin tërësinë e punimeve që duhet për furnizimin dhe vendosjen në vepër të ullukëve prej llamarine, të cilat montohen në muret e gurit me ganxha metalike të cilat vendosen çdo 1 ml, në të cilën përfshihet transporti i materialeve, skeleria dhe gjithçka për të përfunduar këtë proces.

Ky çmim jepet për njësi Lekë/ml.

Punoi:

Ing. Adela HASKURTI

Ing. Xhemal BOZHIQI

Ing. Amarildo MURACI